



- Të reja ▾Kush jemi ▾HistorikuShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjetVideoProgrami i transparencës ▾Kontakt
- Denonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore ▾Policia Kufitare ▾Policia Rugore ▾DonacionePolicimi në Komunitet ▾
- Përmbledhja JavorePër sinjaliziminTë Guximshëm Pa Armë

Breaking News: Raporti i ngjarjeve, 17 korrik 2024
Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë – Vihen në pranga 2 shtetas
Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, gjatë 24 orëve të fundit
Policia e Shtetit – Finalizohet në bashkëpunim me SPAK-un, operacioni policor i koduar “OBLIKA”
Dimal – Finalizohet operacioni i koduar “Befasia”



17/07/2024

Dimal – Finalizohet Operacioni I Koduar “Befasia”

Dimal/Finalizohet operacioni i koduar “Befasia”, sekuestrohen 2 armë zjarri pistoleta, municion luftarak, veshje si të Policisë dhe sende të kundërligjshme.

Stacioni i Policisë Dimal, në zbatim të masave të planit operacional “Sundimi i ligjit”, bazuar dhe në informacionet e siguruar nga inteligjencia policore, për një shtetas që mbante armë zjarri me vete dhe në banesë, ka organizuar operacionin policor të koduar “Befasia”, për kapjen e këtij shtetasi.

Si rezultat i operacionit u arrestua në flagrancë shtetasi M. G., 21 vjeç, banues në fshatin Suk, Fier, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” dhe “Mbajtja pa të drejtë e uniformës”.

Gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin dhe në banesën e këtij shtetasi, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale: 2 armë zjarri pistoleta, krehra dhe municion luftarak për to, veshje si të Policisë, maska, dorashka dhe 1 përforcues grushti.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.



◀ Krujë – Finalizohet operacionin policor i koduar “Plant 4”

Policia e Shtetit – Finalizohet në bashkëpunim me SPAK-un, operacioni policor i koduar “OBLIKA” ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent